



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 1/117
Datë: 30.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009-2018.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/117

Datë: 30.03.2010

Në mbështetje në nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01 /2007, Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, dhe Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nenit 12.2 dhe 16.0 Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2010, mori:

V E N D I M

1. Hapësira ku ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës, në Kleçkë dhe Divjakë, me sipërfaqe prej 1.500,29 ha në komunat; Lypjan, Malishevë dhe Drenas shpallet zonë me interes të veçantë.
2. Për zbatimin e pikës 1. të këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe komunat; Lypjan, Malishevë dhe Drenas.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Komunës - Lypjan
- Komunës - Malishevë
- Komunës - Drenas
- Arkivit të Qeveris



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 3/117

Datë: 30.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Kosovës për anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit propozon z. Naser Osmani.
2. Ngarkohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që propozimin nga pika 1. e këtij vendimi, së bashku me CV-në e kandidatit, t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë